

Prania e dhunës në marrëdhëniet e adoleshentëve

Botues: Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)

Menaxhere Projekti dhe Redaktore: Luljeta Vuniqi

Hulumtimi është jetësuar nga: IQ Consulting

Shkruar nga: Erëblir Kadriu

Përkthyer nga: Xhavit Rexhaj

Realizimi teknik, disenji dhe shtypi: Drin Kryeziu

© 2012 Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Të gjitha të drejtat e rezervuara

www.kgscenter.net



An EU funded project managed by
the European Union Office in Kosovo

Ky botim është realizuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të shfrytëzohet për të reflektuar pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



United Nations Population Fund

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë ato të autorit dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e UNFPA -së, të Kombeve të Bashkuara ose të ndonjërit të organizatave të saj

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	3
Hyrje	7
Falënderimet	9
Metodologjia	11
KONCEPTET	13
DHUNA FAMILJARE	13
MOSTRA E STUDIMIT	15
REZULTATET DHE GJETJET	16
PËRDORIMI I ALKOOLIT DHE I DROGAVE	23
LIDHJET ROMANTIKE – PËRVOJAT DHE SHPESHTËSIA	23
PËRKUFIZIMI I DHUNËS, SIPAS ADOLESHENTËVE	28
MODELET E DHUNËS NË LIDHJET MES ADOLESHENTËVE	30
(MOS)RAPORTIMI I DHUNËS	36
MODELET E MEDIAVE	38
GJETJET E TJERA	39
REKOMANDIMET	40
BIBLIOGRAFIA	41

PËRMBLEDHJE

Studimi në vazhdim shtjellon disa çështje me rëndësi për përvojat e të rinjve lidhur me dhunën në shkolla, familje ose në lidhje romantike. Rezultatet e këtij studimi japin informacione të rëndësishme për qëndrimet dhe sjelljet gjinore të adoleshentëve, si dhe për përvojat e tyre lidhur me incidentet e dhunshme. Në vijim japim gjetjet dhe rezultatet kryesore të këtij studimi.

- Shumica e pjesëmarrësve nga të dyja grupet gjinore kanë raportuar se jetojnë me të dy prindërit
- Për shumicën e pjesëmarrësve religjioni nuk është asnjëherë i rëndësishëm ose është fare pak i rëndësishëm në strukturën e tyre familjare
- Shumica absolute e pjesëmarrësve të të dyja gjinive nuk kanë raportuar asnjë përvojë negative ose të dhunshme me të rriturit e familjeve të tyre. Këto përgjigje vlenin për të dyja gjinitë dhe për format e ndryshme të dhunës, përfshirë atë fizike, emocionale/psikologjike ose seksuale
- Shumica absolute e pjesëmarrësve në këtë studim kanë raportuar një ndjenjë të fuqishme të kënaqësisë
- Të rinjtë dhe të rejat e këtij studimi kanë identifikuar disa lloje të incidenteve të dhunshme që kishin ndodhur brenda shkollave të tyre, si incidente fizike, emocionale, psikologjike dhe dhunë seksuale.
- Sa i përket personave të përfshirë në dhunën shkollore, pjesëmarrësit kanë identifikuar rastet në vijim: 1. Dhunën në mes të nxënësve, 2. Dhunën e mësimdhënësve të drejtuar kundër nxënësve dhe 3. Dhunën e nxënësve të drejtuar kundër mësimdhënësve
- Oborri i shkollës, pasuar nga korridoret, klasat dhe toaletet, ishin vendet ku më së shpeshti u ka ndodhur dhuna në shkollë pjesëmarrësve në këtë studim.
- Në përgjithësi, 63.3% e meshkujve deklaruan se asnjëherë nuk kishin konsumuar pije alkoolike, krahasuar me 74.7 përqind të femrave që nuk kishin provuar alkoolin. Pos kësaj, 88.6% e pjesëmarrësve meshkuj deklaruan se nuk kishin pasur kurrfarë përvojash me drogat, ndërsa te femrat kjo përqindje ishte më e lartë - 95.3%.
- Më shumë se gjysma (52%) e respondentëve të këtij studimi deklaruan të kishin pasur lidhje romantike, një e treta e të cilëve (32%) kishin qenë në lidhje që ngërthente edhe marrëdhëniet seksuale. Shumica e respondentëve ishin në një marrëdhënie në mes të dy muajve dhe dy **3**



viteve, ndërkaq vetëm një dyzinë (14%) ishin në lidhje romantike për një periudhë më të gjatë se dy vite,

- Në anën tjetër, më shumë se një e treta (40%) e atyre që kanë pasur marrëdhënie seksuale kanë përdorur prezervativ si masë mbrojtëse gjatë marrëdhënies së fundit seksuale, ndërsa një përqindje mjaftë brengosëse (prej 33.3%) nuk kanë përdorur kurrfarë mbrojtje. Kjo vlenë sidomos për meshkujt e rinj, 28.9 % e të cilëve, sipas këtij studimi, deklaruan se nuk kishin përdorur asnjë mbrojtje gjatë marrëdhënies së fundit seksuale me personin me të cilin ishin në lidhje romantike, ndërkaq për femrat kjo përqindje ishte edhe më e lartë, 40.8%.
- Dy të tretat e atyre që janë aktualisht në një lidhje romantike janë plotësisht (31%) ose kryesisht (33%) të kënaqur me marrëdhëniet e veta.
- Një numër i madh i meshkujve (46%) dhe i femrave (40%) kanë raportuar përdorim të dhunës kur i riu të ketë goditur vajzën për shkak se ajo e kishte mashtruar.
- Shumica e pjesëmarrësve, 65% prej tyre, besojnë se vajza duhet të jetë e virgjër në kohën kur vendosë që të hyjë në një lidhje romantike. Për më tepër, duket se normat kulturore dhe sociale për virgjërinë femërore kanë më shumë ndikim ndaj femrave se sa ndaj meshkujve, ashtu që 70% e femrave, krahasuar me 59% të meshkujve besojnë se femra duhet të jetë e virgjër kur të hyjë në një marrëdhënie romantike.
- Respondentet (femra) kanë treguar të kuptuar më të mirë lidhur me përkufizimin e dhunës dhe të llojeve të dhunës: fizike, emocionale, psikologjike e seksuale.
- Më pak se një e treta e respondentëve (27%) nuk mendojnë se flakaresha do të mund të definohej si një akt i dhunës. Ky perceptim është më i pranishëm ndër meshkuj se sa ndër femrat.
- Më shumë femra (11%) se sa meshkuj (6%) kanë qenë të lënduara / goditura fizikisht ose kanë marrë goditje me shuplakë.
- Më shumë femra, 10%, se sa meshkuj, 6%, kanë raportuar përvoja nga marrëdhëniet e tyre romantike kur partneri i tyre ka vepruar dhunshëm ndaj tjetrit dhe një gjë e tillë ka zgjuar frikë tek viktimat.
- Pjesëmarrëset kanë raportuar më shumë frikë nga hakmarrja (16.1% për femrat, 10.3% për meshkujt) si një nga arsyt kryesore për mosraportimin e dhunës, ndërkaq më shumë meshkuj (19.6%) se sa femra (10.1%) kanë raportuar ndjenjën e fajit dhe përgjegjësisë si një ndër arsyt kryesore për mosraportim të dhunës.

- Shumica e pjesëmarrësve të këtij studimi besojnë se dhuna është e pranishme sot në lidhjet romantike dhe e shohin atë si një problem dhe shqetësim serioz. Në përgjithësi, femrat (me 84.2%) më shumë se meshkujt (me 68.3%) e kanë ngritur këtë si një çështje alarmuese të marrëdhënieve të sotme ndërgjinore.
- Shumica e të rinjve dhe të rejave kanë treguar për mungesën e aktiviteteve e të strategjive qoftë për luftimin ose për parandalimin e dhunës në shkollat e tyre.





HYRJE

Përkundër sukseseve relative, mund të thuhet se në shoqërinë kosovare ende vazhdojnë të ekzistojnë probleme të mëdha lidhur me praninë e pabarazisë gjinore në një shkallë të gjerë. Një nga fushat më problematike përkitazi me marrëdhëniet gjinore lidhet me dhunën me baza gjinore, e cila vërehet të ekzistojë qysh herët në jetën e të rinjve të Kosovës.

Deri vonë, shumica e studimeve lidhur me dhunën në mes të partnerëve janë përqendruar në çiftet e martuara ose ato në bashkëjetesë. Kjo megjithatë ka lënë anash, me përjashtime të rralla, çështjen e dhunës në shkollë dhe atë në mes të personave me marrëdhënie romantike jorezidenciale të bazuar në takime, të cilat janë karakteristike gjatë viteve të para të moshës së pjekurisë. Kur merret parasysh prania më e lartë e dhunës në mes të partnerëve të rinj, rezulton se studimi i këtyre marrëdhënieve të këtyre moshave dhe intervenimet përkatëse janë të një rëndësie vendimtare. Sjelljet konfliktuoze dhe dhuna familjare që shpërthen në vitet e pjekurisë fillet e veta i ka në përvojat adoleshente të takimeve romantike.

Qendra Kosovare për Studimet Gjinore ka jetësuar një nismë për praninë e dhunës në marrëdhëniet në mes të adoleshentëve me qëllim që të trajtojë mungesën e studimeve e të njohurive për çështjet e dhunës me baza gjinore në radhët e të rinjve, ose më saktë praninë e dhunës në lidhjet romantike të adoleshentëve. Me këtë hulumtim të titulluar "Prania e dhunës në marrëdhëniet e adoleshentëve" QKSGJ-ja synon të ofrojë vlerësimet e para, të bazuara në një mostër reprezentative në shkallë kombëtare, për praninë e viktimizimit e të dhunës fizike e psikologjike në marrëdhëniet romantike të adoleshentëve.

Ky raport paraqet rezultatet e modeleve më të përgjithshme hulumtuese, dallimin dhe të kuptuarit e dhunës në baza gjinore në marrëdhëniet adoleshente në Kosovë. Qëllimi i hulumtimit ishte që të mblidhen informacione për praninë, llojet, motivet, shkaqet dhe pasojat e dhunës në marrëdhëniet e adoleshentëve përmes dokumentimit të të kuptuarit dhe konceptualizimit të të rinjve për dhunën në këto marrëdhënie. Qëllim tjetër i hulumtimit ka qenë që të kuptohen më mirë nevojat dhe problemet e të rinjve përkitazi me çështjet që lidhen me dhunën në lidhje, krijimin e programeve më të mira arsimore dhe përdorimin e rezultateve të hulumtimit për të informuar fushatat e ndryshme për parandalimin e dhunës me baza gjinore.

Objektivat e fushatës janë që të krijohet vetëdija për nevojën e eliminimit ⁷



të stereotipeve gjinore dhe shkaqet e tjera të dhunës në baza gjinore në mesin e të rinjve, duke i ndërgjegjësuar ata për përgjegjësinë e tyre për pjesëmarrje aktive në vendimmarrjen shoqërore në fushën e barazisë gjinore dhe në promovimin e kësaj barazie si pjesë e vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve të të rinjve. Pos hulumtimit, fushata përfshinë edhe aktivitetet në vijim:

Fushatë në medie - dokumentarë televiziv, këngë të popullarizuar, shpallje në gazeta e të tjera

Punë e të rinjve në fushën e dhunës në baza gjinore përmes përdorimit të teknikave krijuese si piktura, sprovë, grafitë murale, filma të animuar e të tjera;

- Shfaqje teatrore
- Diskutime publike dhe debate me të rinj;
- Avokim dhe lobizim.

FALËNDERIMET

Hulumtimi “Prania e dhunës në marrëdhëniet e adoleshentëve” është një nismë e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore. Në emër të QKSGJ, do të doja së pari të shprehi falënderimin dhe mirënjohjen ndaj Komisionit Evropian që e ka bërë të mundshëm këtë hulumtim.

Po ashtu, do të doja të falënderoja Ministrinë e Arsimit, të Shkencës e të Teknologjisë të Kosovës, shkollat e mesme dhe respondentët e shumtë për ndihmën e tyre të çmuar dhe gatishmërinë për të kontribuar me kohën e vet dhe për të marrë pjesë në hulumtimin tonë. Gatishmëria për bashkëpunim dhe përkrahja e tyre na e ka mundësuar që të mbledhim të dhënat e nevojshme për të analizuar çështjet e trajtuara nga ky hulumtim.

Pos këtyre, ekipi dëshiron të falënderojë të gjithë intervistuesit për përkushtimin e tyre dhe gatishmërinë për bashkëpunim.

QKSGJ i falënderon edhe të gjithë pjesëmarrësit e grupeve punuese, të cilët e kanë pasuruar këtë studim me dijen dhe rekomandimet e veta.

Përveç kësaj do të doja të falënderoj edhe ekipin e kompanisë IQ Consulting për kontributi e tyre profesional dhe bashkëpunimin gjatë zbatimit të hulumtimit.

Falënderime të veçanta për mbështetjen të vazhdueshme gjatë zbatimit të projektit janë edhe për anëtarët e tjerë të Stafit të QKSGJ, Znj. Luljeta Demolli, Sibel Halimi, Merita Fona dhe Driton Parduzin.

Luljeta Vuniqi

Menaxhere e Projektit





METODOLOGJIA

Instrumentet e përdorur gjatë realizimit të hulumtimit “Çështjet e dhunës në lidhjet adoleshente” janë: instrumentet cilësore dhe sasore. Në anën cilësore, janë përfshirë të dhëna dytësore hulumtuese si dhe diskutime nga fokus grupet si pjesë e metodologjisë. Në aspektin sasior, është zhvilluar një pyetësor që ka synuar tri audiencia dhe janë përfshirë 600 respondentë në 54 shkolla (mostër e mjaftueshme për të siguruar të dhëna statistikore relevante) anëmbanë Kosovës.

Pyetësori përfshin 42 pyetje, prej te cilave dy pyetje janë të llojit të hapur përderisa pyetjet e tjera janë të llojit të mbyllur të formuara si shkallë nominale dhe ordinare. Pyetësorin e plotësojnë vetëm respondentët e shkollave të mesme, ndërsa përbëhet nga temat si në vijim:

- Karakteristikat personale;
- Përvojat e dhunës në familje;
- Përvojat në lidhje;
- Përvojat e dhunës në lidhje;
- Qëndrimet për rolet gjinore dhe dhunën;
- Njohja e mënyrës së dhunës dhe shenjat e dhunës në lidhje (çift);
- Përvojat e dhunës në shkollë, në vendbanim/kuarte;
- Grupet moshatare dhe dhuna;
- Ndikimi dhe roli i medieve;
- Edukimi dhe parandalimi i dhunës në shkolla;

Gjuha dhe kuptimi i përmbajtjes dhe mjaftueshmëria e instrumentit matës është vërtetuar dhe është përshtatur më tej pas pilot testit me grupin e nxënësve dhe nxënësve të shkollave të mesme.

Për aplikimin e pyetësorit në shkolla është kërkuar dhe është marrë aprovim për realizimin e anketave nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Mostra është konstruktuar si një mostër e stratifikuar rastësisht krahasuar me strukturën gjinore të popullatës së shkollave të mesme, llojit të shkollave brenda sistemit të Arsimit të Mesëm (Gjimnazet, shkollat profesionale/ teknike, ekonomike, bujqësisë dhe mikse), madhësia dhe pozita gjeografike **11**



e vendbanimit, përkatësisë etnike, gjinisë dhe moshës në të gjitha komunat e Kosovës ku janë zgjedhur shkollat. Zbatimin e pyetësorit e kanë realizuar anketuesit profesional të trajnuar specifikisht për temën e hulumtimit. Para se të fillojë plotësimi i pyetësorit, respedentëve u është prezantuar tema dhe objektivat e hulumtimit me udhëzime për çështjet e parashtruara në pyetësor. Të dhënat kuantitative janë analizuar duke përdorur programin për përpunimin statistikor SPSS 16. Të dhënat cilësore janë përdorur si shembuj, komente, “fjalë e gjallë” e respedentëve të anketuar që do të thotë një kontribut i rëndësishëm për të kuptuar dhe sqaruar rezultatet numerike. Të gjitha informatat e mbledhura me ndihmën e pyetësorëve janë trajtuar si anonime dhe shumë konfidenciale dhe vetëm grupi i hulumtuesëve ka pasur qasje në të dhëna. Pas përpunimit të të dhënave dhe krijimit të data bazës, janë realizuar dy fokus grupe, njëra duke përfshirë me mostër reprezentative nxënës/e të shkollave të mesme ku janë analizuar dhe diskutuar në grup të dhënat / rezultatet e dalura nga anketa. Derisa fokus grupi i dytë është realizuar me akterët kyç të fushës së arsimit dhe çështjeve gjinore, për të përpiluar konkluzionet dhe rekomandimet.

Qëllimi i fokus grupeve është për të verifikuar rezultatet e dalura nga anketa dhe është bërë përpjekje për të gjetur përgjigje në pyetjet ‘Pse’ dhe ‘Si’ në temat të cilat janë trajtuar në anketë si dhe për të përmbledhur konkluzionet dhe rekomandimet.

KONCEPTET

Për të kuptuar më qartë gjetjet e këtij studimi është me rëndësi të përshkruhen disa koncepte që përdoren përgjatë këtij raporti dhe ishin pjesë e instrumentit të përdorur për mbledhjen e të dhënave ose janë nxjerrë nga pjesëmarrësit e këtij studimi. Konceptet janë përdorur sipas këtyre përkufizimeve:

DHUNA FAMILJARE

Dhuna familjare, e njohur edhe si “dhuna ndërpersonale” “rrahje” dhe “dhuna në familje”, është një problem serioz dhe mjaftë i shpërndarë i shëndetit publik. Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Grave vlerëson se një nga tri gra në mbarë botën do të përjetojnë rrahjen, seksin e detyruar ose abuzime të tjera gjatë jetës së tyre. Kjo njësi merret me përkufizimet e dhunës familjare, perspektivat historike, shkaqet e rrahjeve, efektet e dhunës familjare, fëmijët e grave të rrahura, si dhe reagimet e parandalimi. Nocioni i “gruas së rrahur” rrjedh nga akti penal i njohur si “rrahje” ose prekja e qëllimshme e një personi në kundërshtim me vullnetin e atij personi nga ana e një personi tjetër, ose përmes një objekti ose substance të përdorur nga ky person. Nocioni i “gruas së rrahur” me theksin në dhunën fizike, nuk i përfshinë plotësisht mënyrat e ndryshme në të cilat mund të manipulohet dhe të abuzohet cilido partner në lidhje dhe për pasojë, termi është zëvendësuar në masë të madhe nga dhuna familjare (DhF), dhuna ndaj partnerit në lidhje (DhPL), si dhe termi më i përgjithshëm dhuna në familje. Gjatë 15 viteve të kaluara, po pranohej gjithnjë e më shumë se DhPL është një dukuri e shpeshtë dhe problem i theksuar i shëndetit publik me efekte shkatërruese ndaj individëve, familjeve dhe komuniteteve. Termi dhuna në familje përdoret për të përshkruar aktet e dhunës në mes të anëtarëve të familjes, përfshirë partnerët e rritur dhe ata adoleshentë, dhunën në mes të prindit e fëmijës (përfshirë fëmijët e rritur), në mes të kujdestarëve ose partnerëve kundër më të moshuarve dhe në mes të moshatarëve. Edhe pse shpesh përdoren me të njëjtin kuptim, termi dhuna familjare është një nënndarje e dhunës në familje në mes të partnerëve në një lidhje, ashtu që termi dhuna në mes të partnerëve në lidhje duket se po ia zë vendin dhunës familjare për të siguruar më shumë qartësi në përkufizim.

- **Adoleshentë / meshkuj të rinj e femra të reja** – nxënës të shkollave të mesme të Kosovës prej ku është përzgjedhur mostra e hulumtimit. **13**



Një kriter specifik për përkufizimin e këtij nocioni është grup-mosha e pjesëmarrësve, që është 16 – 19 vjeç, sipas përkufizimit në shtrirjen dhe qëllimin e këtij studimi.¹

- **Vetëperceptimi (perceptimi i vetvetes)** – nga pikëvështrimi psikologjik “vetvetja / imazhi për vetveten” rezulton nga tri procese të rëndësishme: ¹. Pikëpamja që ai/ajo ka për vetveten,². Pikëpamja që të tjerët kanë për atë, dhe 3. Pikëpamja që ai/ajo ka për perceptimin e të tjerëve për atë. Ky studim ka kërkuar nga pjesëmarrësit që të reflektojnë për vlerat e sjelljet e veta dhe për nocionin e vlerës së vet. Refleksionet e pjesëmarrësve për perceptimin e vet të vlerave, aftësive, ndjenjës së vlerës, krenarisë e të tjera, janë kategorizuar dhe interpretuar në suaza të këtij nocioni.
- **Dhuna në shkollë** – lloje të ndryshme² të incidenteve të dhunshme që ndodhin brenda ndërtesave shkollore, në oborrin e shkollës dhe në afërsi të saj. Janë paraqitur përvojat e dhunës ku përfshijnë disa pjesëmarrës: dhuna në mes të nxënësve, dhuna e nxënësve ndaj mësimitdhënësve dhe dhuna e mësimitdhënësve ndaj nxënësve.
- **Lidhjet Romantike Adoleshente** – një tërheqje emocionale dhe lidhje në mes të personave që mund të përfshijë ose të mos përfshijë edhe marrëdhëniet seksuale. Për qëllime të këtij studimi, pjesëmarrësit, adoleshentët, janë pyetur të tregojnë nëse 1. Kanë pasur një lidhje më parë dhe 2. Janë në një lidhje romantike me dikë gjatë kohës së mbledhjes së të dhënave për këtë studim. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të raportojnë kohëzgjatjen e lidhjes së tyre romantike si dhe informacione për marrëdhënie seksuale me partnerin e vet romantik.
- **Mbrojtja seksuale dhe personat seksualisht aktiv** – persona aktiv seksual janë ata që kanë pasur ose që janë aktualisht në një lidhje që përfshinë marrëdhënie seksuale³ me partnerin e vet romantik. Mbrojtja seksuale u referohet llojeve të ndryshme të matjes që asaj që quhet seks i sigurt– seks që nuk rezulton në shtatzëni të padëshiruar dhe/ose infeksion me sëmundje të ndryshme që barten përmes rrugëve seksuale.
- **Qëndrimet ndaj roleve gjinore** – qëndrimet për një person, objekt dhe / ose dukuri formësohen nga përvojat tona dhe nga informatat kthyesë për ato përvoja. Qëndrimet janë mendime me një dozë llojllojshmërie të emocioneve që kemi ndaj dikujt apo diçkaje. Për qëllimet

¹ Ju lutem shihni pjesën MOSTRA E KËTIJ STUDIMI e këtij raporti për informata më të hollësishme për këtë mostër.

² Ju lutem shihni pjesën DHUNA NË SHKOLLË për përshkrimin dhe përkufizimin e: dhunës fizike, dhunës psikologjike, dhunës emocionale dhe dhunës seksuale në lidhje me incidentet e dhunshme të raportuara nga pjesëmarrësit në këtë studim.

³ Llojet e marrëdhënieve seksuale nuk janë identifikuar.

e këtij studimi, nga pjesëmarrësit është kërkuar të tregojnë qëndrimet e veta për vlerat e caktuara, si dhe për të pritmet e tyre për sjelljet e meshkujve e të femrave në shoqërinë tonë.

MOSTRA E STUDIMIT

Mostra e këtij studimi ishte shumë e nduarduart sa i përket gjinisë së pjesëmarrëse, moshës së tyre, nivelin e llojin e arsimit, suksesit të tyre në shkollim dhe përkatësinë kombëtare.

Gjinia:

MESHKUJ	FEMRA
281	316
GJITHSETË: 597	

Mosha dhe arsimit⁴

	MESHKUJ	FEMRA
- MOSHA -		
16	15.7	17.7
17	47.7	45.3
18	25.6	27.8
19	11.0	9.2
- KLASA -		
11	17.1	21.5
12	63.3	64.2
13	19.6	14.2
- LLOJI I SHKOLLËS -		
Gjimnaz	71.5	74.1
Profesionale	28.5	25.9
- SUKESI NË SHKOLLË -		
Shkëqyeshëm	39.1	52.2
Shumë mirë	37.7	33.9
Mirë	17.8	11.1
Mjaftueshëm	4.6	1.9
Pamjaftueshëm	0.7	0.9

⁴ Përgjigjet janë raportuar duke u bazuar në përqindjet e mostrës së përgjithshme.

Përkatësia kombëtare

Shqiptar – Kosovar	520
Pakicat kosovare joshqiptare	80

REZULTATET DHE GJETJET

FAMILJA, RELIGJIONI DHE PËRVOJAT ME TË RRITURIT

Shumica e pjesëmarrësve nga të dyja grupet gjinore, gjithsejtë 87.8% e tyre, kanë treguar se jetojnë aktualisht me të dy prindërit. Pak prej tyre, gjithsejtë 5.9%, thanë se jetojnë vetëm me nënën e vet. Jeta vetëm me nënën ishte e përbashkët për të dyja gjinitë, për 6% të femrave dhe për 5.7% të meshkujve.

Të pyetur për parimet, besimin dhe praktikat fetare në shtëpinë e vet, pjesëmarrësit e të dyja gjinive treguan ngjashmëri të konsiderueshme në përgjigjet e veta. Gjithsejtë, 46.7% e pjesëmarrësve raportuan se religjioni nuk ishte pjesë e familjes së tyre, ndërkaq nga këta meshkujt me 51.6% kishin dhënë më shumë përgjigje të këtilla nga femrat me 42.4% që nuk praktikonin religjionin në familje.

	GJITHSEJTË	MESHKUJ	FEMRA
JO, religjioni kurrë nuk ka qenë i rëndësishëm në familjen time	46.7%	51.6%	42.4%
Religjioni është me rëndësi në familjen time, por jo edhe aq.	36.2%	31.3%	40.5%
PO, familja ime funksionon në pajtim me parimet religjioze.	17.1%	17.1%	17.1%

TABELA 1.0. A JENI RRITUR NË NJË FAMILJE KU RELIGJIONI ËSHTË I RËNDËSISHËM?

Në këtë studim, adoleshentët kanë raportuar edhe për përvojat e tyre me personat e rritur në familjet e tyre. Shumica absolute e pjesëmarrësve të të dyja gjinive nuk kanë raportuar përvoja negative, armiqësore ose të dhunshme me të rriturit në familjet e veta. Këto përgjigje vlejnjë për të dyja gjinitë dhe për llojet e ndryshme të dhunës: fizike, emocionale, psikologjike ose sociale.

Në përgjithësi, mungesa e dhunës fizike në raport me të rriturit në familje si rrahja, shtrëngimi ose flakareshat, ose thënë ndryshe, zgjidhje e konflikteve me përdorim të forcës fizike ishin raportuar nga gjithsejtë 94.3% të pjesëmarrësve (91.1% e pjesëmarrësve femra dhe 97.2% e pjesëmarrësve meshkuj); respektivisht, 95% e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve nga të dyja gjinitë (96.5% e pjesëmarrësve femra dhe 93.2% e pjesëmarrësve meshkuj).

Shumica absolute e adoleshentëve që morën pjesë në këtë studim kanë raportuar mungesë të përvojave të rëndësishme të dhunës psikologjike / emocionale me të rriturit në familjet e tyre. Më saktë, gjithsejtë 86.3% e të gjithë pjesëmarrësve (88.3% e femrave dhe 84.4% e meshkujve) nuk deklarojnë ndonjë përvojë të ofendimit ose të nënçmimit nga ana e të rriturve në familjen e tyre. Për më tepër, edhe këtu, shumica absolute e pjesëmarrësve nga të dyja grupet gjinore, ose 91.3% e tyre, kanë thënë se nuk janë të frikësuar ose të kërcënuar nga të rriturit. Nuk ka dallime të rëndësishme gjinore as përkitazi me këtë lloj të dhunës me 88.3% të femrave dhe 84% të femrave.

Sipas pjesëmarrësve të këtij studimi, shumica absolute e adoleshentëve të anketuar, ose 93.3%, nuk kanë raportuar përvoja të dhunës seksuale me të rriturit. Më saktë, 94.3% e të gjithë pjesëmarrësve dhe 92.2% e të gjithë pjesëmarrësve meshkuj, thanë se nuk kanë asnjë përvojë të detyrimit në sjellje të padëshiruar seksuale.

	GJITHSEJTË PO	MESHKUJ PO	FEMRA PO
Të rriturit bërtasin shpesh.	30.2%	27.8%	16.2%
Të rriturit ju ofendojnë shpesh dhe ju thërrasin me emra nënçmues	13.7%	16.0%	11.7%
Të rriturit kontrollojnë duke ju mbyllur ose duke mos ju dhënë ushqim.	3.4%	3.9%	2.8%
Të rriturit ju dënojnë duke mos ju lejuar të përdorni telefonin ose duke ua ndaluar daljen në qytet.	17.6%	12.1%	22.5%
Të rriturit ju rrahin, ju shtrëngojnë, ju kapin për flokë ose ju godasin me pëllëmbë.	5.7%	8.9%	2.8%
Të rriturit ju kërcënojnë dhe ju frikësojnë	8.7%	8.5%	8.9%
Të rriturit ua marrin gjërat dhe i shkatërrojnë ato me qëllim.	6.9%	5.3%	8.2%
Konfliktet zgjidhen me përdorim të forcës fizike.	5.0%	6.8%	3.5%
Të rriturit janë të dhunshëm nën ndikimin e alkoolit ose të drogës	16.8%	21.7%	12.3%
Të rriturit ju detyrojnë në sjellje të padëshiruar seksuale.	6.7%	7.8%	5.7%

TABELA 2.0. Përvoja me të rriturit në familje

PERCEPTIMI I VETVETES DHE KËNAQSHMËRIA ME VETVETEN

Shumica absolute e pjesëmarrësve në këtë studim kanë raportuar një ndjenjë të kënaqshmërisë me vetveten. Të pyetur se sa janë të kënaqur me vetveten, gjithsejtë 56.3% e pjesëmarrësve raportuan përgjigje pozitive (11.4% thanë Deri diku e vërtetë dhe 44.9% thanë Plotësisht e Vërtetë). Nuk kishte shumë dallime në mes të gjinive të pjesëmarrësve lidhur me këtë; gjithsejtë 80% e femrave (30.7% Deri diku e vërtetë dhe 57.3% Plotësisht e vërtetë) dhe 89.4% e meshkujve (36.7% Deri diku e vërtetë dhe 52.7% Plotësisht e vërtetë). Në anën tjetër, kur u pyetën nëse kanë diçka për t'u krenuar me vetveten, shumica e pjesëmarrësve nga të dyja gjinitë nuk ishin të sigurtë ose u përgjigjen negativisht. Gjithsjet, 57.5% treguan pasiguri dhe mospajtim me krenarinë për atë se kush janë dhe çka kanë (10.9% Nuk jam i/e sigurt, 11.6% Deri diku e pavërtetë, 35% Plotësisht e pavërtetë). Edhe këtu, kishte përgjigje të ngjashme ndërmjet dy gjinive duke përfshirë 58.5% për femrat dhe 56.3% për meshkujt.

Është interesant se të pyetur nëse ishin në gjendje të kryenin ndonjë punë / detyrë sikurse njerëzit e tjerë, shumica e pjesëmarrësve u përgjigjen me një PO të fuqishme. Gjithsejtë, 88.2% e pjesëmarrësve treguan siguri në përgjigjet e tyre ndaj pyetjes së mësipërme (76.5% Plotësisht e vërtetë, 11.7% Deri diku e vërtetë). Pjesëmarrëset femra treguan siguri më të lartë, 89.4% e tyre besojnë se janë të afta të kryejnë çfarëdo pune / detyrë sikurse njerëzit e tjerë (80.4% Plotësisht e vërtetë, 9.2% Deri diku e vërtetë). Pak dallim prej tyre tregojnë edhe meshkujt, me gjithsejtë 86.8% (72.2% Plotësisht e vërtetë, 14.6% Deri diku e vërtetë).

Pjesëmarrëset femra në këtë studim kanë raportuar me shumë kënaqshmëri me cilësitë që kanë se sa meshkujt. Gjithsejtë 85.1% e pjesëmarrësve femra thanë se kanë shumë cilësi të çmueshme (56.3% Plotësisht e vërtetë, 28.8% Deri diku e vërtetë). Kjo është më e lartë se tek pjesëmarrësit meshkuj, të cilët në masën 72.9% thanë se kanë shumë cilësi të çmueshme (49.8% Plotësisht e vërtetë, 23.1% Deri diku e vërtetë). Niveli i kënaqshmërisë së femrave me cilësitë e veta është më i lartë edhe se rezultati i përgjithshëm i pjesëmarrësve për të dyja gjinitë (79.4%). Zakonisht, kur janë pyetur nëse besojnë se janë të vlefshëm sa edhe njerëzit e tjerë, më shumë pjesëmarrëse femra, 80.4%, kanë thënë po (62% Plotësisht e vërtetë, 18.4% Deri diku e vërtetë) se sa meshkujt, 76.2% (54.1% Plotësisht e vërtetë, 22.1% Deri diku e vërtetë).

18 Në përgjithësi, 63.2% e të gjithë pjesëmarrësve deklaruan se nuk ndjehen



të pavlefshëm; sa i përket aspektit gjinor: gjithsejtë, 61.4% e pjesëmarrëseve femra thanë se nuk ndihen të pavlefshme krahasuar me 65.1% të pjesëmarrësve meshkuj. Në anën tjetër, gjithsejtë 47.7% e pjesëmarrësve nga të dyja gjinitë thanë se nuk ndihen asnjëherë të pavlefshëm, ndërsa 18.8% prej tyre ishin të pasigurtë. Kjo përgjigje nuk dallon shumë në mes të dy gjinive, ashtu që kjo ishte e vërtetë për 47.5% të femrave dhe për 48.8% të meshkujve. Megjithatë, më shumë meshkuj (22.4%), sesa femra (15.5%), treguan pasiguri lidhur me këtë pyetje.

	GJITHSEJTË PO ¹	MESHKUJ PO	FEMRA PO
Në përgjithësi jam i kënaqur me vetveten.	88.6%	89.4%	88%
Do të doja të kisha më shumë respekt për vetveten	57.3%	56.3%	58.2%
Mendoj se kam shumë për t'u krenuar me vetveten	42.5%	43.7%	41.5%
Ndonjëherë ndihem krejtësisht i padobishëm	47.7%	29.6%	37.1%
Jam i aftë të kryej çdo punë dhe në gjendje të bëj detyrat e mia sikurse çdo njeri tjetër.	33.5%	86.8%	89.6%
Ndonjëherë ndihem i pavlerë.	88.2%	24.2%	26.6%
Mendoj se jam po aq i aftë sa edhe shumica e njerëzve të tjerë	25.4%	76.9%	86.4%
Mendoj se kam shumë cilësi të vlefshme	81.9%	72.9%	85.1%
Çdo ditë e më shumë kuptoj se jam me pak vlerë.	49.4%	17.5%	17.7%
Mendoj se jam i vlefshëm sa edhe njerëzit e tjerë.	17.6%	76.2%	80.4%

TABELA 3.0 Perceptimi i vetvetes ndër të rinjtë dhe të rejt

DHUNA SHKOLLORE

Ekziston një dakordim i përgjithshëm në mes të palëve të interesit se dhuna shkollore në Kosovë ka potencial të shndërrohet në një çështje alarmuese për shkak të tendencave të rritjes. Sipas të dhënave zyrtare nga Policia e Kosovës (cituar në Koha DITORE, 8 tetor 2012), prej janarit deri më shtator 2012, janë raportuar gjithsejtë 2,793 raste të lëndimeve trupore. "Kjo është veçanërisht e theksuar në mesin e adoleshentëve në shkollat fillore e të mesme".

Numri i incidenteve të dhunshme brenda shkollave të Kosovës po tregojnë **19**



jnë tendenca të rritjes. Më saktë, “Në gjysëmvetorin e vitit 2011, janë raportuar më shumë se 210 incidente ku janë përfshirë nxënësit, në disa raste edhe me lëndime serioze. Kjo shënon një përkeqësim të situatës krahasuar me vitin 2010 kur, sipas të dhënave të policisë, kishin ndodhur 37 incidente me përfshirje të lëndimeve të rënda trupore, 36 raste të dëmtimit të pronës, 15 vjedhje dhe një numër i papërcaktuar i dëmtimeve të lehta trupore”. (Brajsjori, SETimes, 2011)⁵

Për më tepër, UNICEF-i që prej vitit 2005 ka alarmuar në raportet e veta për dhunën shkollore në Kosovë: “dhuna është e zakonshme në shkolla dhe ka shënuar rritje në këto komunitete gjatë disa viteve të fundit. Ata po ashtu besojnë se frika nga dhuna në rrugë ose rrugës për në shkollë është e përhapur në mesin e të rinjve”. (UNICEF, Research into Violence against Children in Schools in Kosovo 2005:41). Shoqëria civile në Kosovë është angazhuar në avokim për një studim gjithëpërfshirës për dhunën në shkolla për të përcaktuar rastet e paraqitjes, shkaqet dhe implikimet e kësaj dukurie për zhvillimin e vendit dhe për mirëqenien shoqërore (shih International Progressive Education – www.ipeks.org)

Në vijim jepen kategoritë e llojeve të raportuara të dhunës që kanë ndodhur në mesin e adoleshentëve në shkollë, pjesëmarrësit në këto incidente të dhunshme, shkaqet më të shpeshta që nxisin dhunën, si dhe vendet ku ndodhin këto incidente më së shpeshti.

DHUNA NË MES TË NXËNËSVE

Vërehet një prani e madhe e dhunës fizike dhe e përlëshjeve në mes të nxënësve. Këtë e thonë 77.1 % e pjesëmarrësve në anketë nga të dyja gjinitë. Shumica e respondentëve (67.8%) nga të dyja gjinitë kanë raportuar edhe ofendime dhe tallje në mes të nxënësve. Disa pjesëmarrës kanë raportuar edhe raste kur nxënësit bartin në shkollë armë të ftohta, si thika (gjithsejtë 44.6%), shkopinj bejsbolli (gjithsejtë 37.4%), dhe i vjedhin gjërat personale të njëri-tjetrit (gjithsejtë 45.2%). Disa pjesëmarrës, 18.1% syresh, tregojnë për përvoja me nxënës që bartin edhe revole në shkollë. Lidhur me këto përvoja nuk ka dallime gjinore në përgjigje në mes të pjesëmarrësve.

DHUNA MËSIMDHËNËS – NXËNËS

Në përgjithësi, shumica e adoleshentëve të këtij studimi, 53.4%, kanë raportuar raste të mësimdhënësve që i ofendojnë nxënësit. Këto përvoja

20 ⁵ Brajsjori, Muhamet. (2011). Dhuna në shkollë bëhet vdekjeprurëse. Southeast European Times në Prishtinë. E nxjerrë nga interneti më 12 nëntor 2012 nga [www në http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2011/06/08/feature-04](http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2011/06/08/feature-04)



raportohen më shumë prej respondentëve vajza (57.3% syresh), se pjesëmarrësit meshkuj (49.1%). Përkundër legjislacionit vendor në fuqi që në mënyrë të qartë ndalon çfarëdo lloji të qëndrimeve dhe sjelljeve të dhunshme të mësimdhënësve të drejtuara kundër nxënësve, një numër i madh i adoleshentëve (gjithsejtë 42.2%) raportojnë raste të përdorimit të dënimeve fizike ndaj nxënësve nga ana e mësimdhënësve dhe kërcënim dhe frikësim të nxënësve po nga mësimdhënësit (raportuar nga (39.9% prej tyre). Dhuna psikologjike⁶ rrezikon krijimin e një mjedisi të sigurtë e të rehatshëm të të nxënësve, gjë që ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e të nxënësve (Kadriu e të tjerët, 2010)⁷ në klasa. Nëse nuk plotësohen nevojat psikologjike, emocionale dhe kognitive të nxënësve dhe nëse nuk krijohet një mjedis i sigurtë i të nxënësve, atëherë nuk mund të pritët që të mësohet shumë në një situatë të tillë. Në bazë të përgjigjeve të pjesëmarrësve të në këtë studim, këto përvoja janë të ngjashme për pjesëtarët e të dyja grupeve gjinore. Pos kësaj, është me rëndësi të vërehet se një numër i madh i pjesëmarrësve nga komunitetet pakicë (42.0%), ndajnë të njëjtat përvoja.

DHUNA NXËNËS – MËSIMDHËNËS

Në përgjithësi, 42.2% e të gjithë pjesëmarrësve thanë se mësimdhënësit ofendohen nga nxënësit e tjerë. Për më tepër, disa pjesëmarrës, gjithsejtë 21.3% e tyre, raportuan përvoja me nxënës të cilët kërcënojnë dhe frikësojnë mësimdhënësit dhe 18.4% e të gjithë pjesëmarrësve kanë raportuar përdorimin e dhunës fizike nga nxënësit kundër mësimdhënësve.

VENDNDODHJET E DHUNËS SHKOLLORE

Adoleshentët femra dhe meshkuj të këtij studimi identifikuar vendet ku ndodhin rastet më të shpeshta të dhunës e të përlëshjeve në shkollë ose në afërsi të shkollës. Këto janë: 1. Oborret e shkollave për 85.4% të respondentëve, 2. Kur nxënësit humbin orët për 66% prej tyre, 3. Në mes të ndërrimeve për 64.8%, 4. Gjatë pushimeve në mes të orëve 61.1% prej tyre, 5. Rrugës duke u kthyer nga shkolla për 55.9% prej tyre dhe 6. Në korridoret e shkollave për 52.4% prej tyre.

⁶ Definicioni dhe përshkrimi i dhunës psikologjike i përdorur për qëllim të këtij studimi është i elaboruar në pjesën 7 të këtij raporti ku pjesëmarrësit raportojnë shembujt e këtij lloji të dhunës

⁷ Kadriu, E., Selimos, E., Tower, J. (2010), Çka duhet për të qenë mësimdhënës i mirë? Arsimi Përprimitar Ndërkombëtar, Kosovë.



	GJITHSEJTË	MESHKUJ	FEMRA
Toaletet	37.5%	33.5%	41.1%
Korridoret	52.4%	46.3%	57.9%
Klasat	49.2%	49.5%	49.1%
Oborret e shkollave	85.4%	84.3%	86.4%

TABELA 4.0. Vendndodhjet më të shpeshta të dhunës shkollore

SHKAQET E DHUNËS SHKOLLORE

“Ka përlshje (në mes të djemve) për shkak të vajzave, megjithëse kohëve të fundit një gjë e tillë ka filluar të ndryshojë”.

Një pjesëmarrës adoleshent në grupin e fokusit

Shumica absolute e adoleshentëve femra dhe meshkuj të këtij studimi kanë identifikuar katër arsye pse ndodhin incidentet e dhunës në mjediset shkollore. Këto janë: 1. Shoqëria e keqe e nxënësve për 84.3% prej tyre, 2. Mbrojtja e shokut për 81.2%, 3. Hakmarrja /inatet për 75.7% prej tyre dhe 4. Thirrja me emra përçmues për 74.7% prej tyre.

	GJITHSEJTË PO	MESHKUJ PO	FEMRA PO
Tallja dhe ofendimet në mes të nxënësve	67.8%	66.5%	69%
Përlshjet në mes të nxënësve	77.1%	76.2%	77.8%
Shkatërrimi i orendive të ndryshme shkollore (karrigat, bangat, dyert, dritaret)	58.6%	54.8%	62%
Nxënësit ofendohen nga mësimdhënësit	53.4%	49.1%	57.3%
Përlshjet me nxënësit nga shkollat e tjera	45.6%	45.9%	45.3%
Mësimdhënësit përdorin dhunën fizike kundër nxënësve	28.0%	28.1%	27.8%
Mësimdhënësit ofendohen nga mësimdhënësit	42.2%	41.6%	42.7%
Kërcënimet që vijnë nga të huajt / njerëzit jashtë shkollës	43.9%	46.6%	41.5%
Përlshjet në mes të djemve dhe vajzave	39.9%	38.8%	48.4%
Mësimdhënësit i frikësojnë dhe i kërcënojnë nxënësit	39.9%	39.9%	39.9%
Nxënësit që bartin thika	44.6%	47.7%	41.8%
Nxënësit që bartin shkopinj bejzbolli	37.4%	37.7%	37.0%
Vjedhja e gjërave personale	45.2%	45.6%	44.9%
Nxënësit kërcënojnë dhe i frikësojnë mësimdhënësit	21.3%	23.1%	19.6%
Nxënësit bartin armë në shkollë	18.1%	20.6%	19.8%
Nxënësit përdorin dhunë fizike kundër mësimdhënëseve	18.4%	18.1%	18.7%

TABELA 5.0. Incidentet e dhunës shkollore

PËRDORIMI I ALKOOLIT DHE I DROGAVE

Shumica e pjesëmarrësve nga të dyja grupet gjinore treguan se nuk përdorin alkool (69.3% prej tyre) ose droga 92.1% e tyre. Megjithatë, kishte ca dallime në përgjigjet në mes të pjesëmarrësve të të dy grupeve gjinore përkitazi me përdorimin e alkoolit dhe drogave. Gjithsejtë, 63.3% e meshkujve asnjëherë nuk kishin pirë pije alkoolike, ndërkaq tek femrat kjo vlente për 74.7% orej tyre. Pos kësaj, gjithsejtë 88.6% e pjesëmarrësve meshkuj raportuan se nuk kishin asnjë përvojë me droga, ndërkaq tek femrat kjo përqindje ishte më e madhe, 95.3% e tyre deklaruan se nuk i kishin provuar drogat asnjëherë.

LIDHJET ROMANTIKE – PËRVOJAT DHE SHPESHTËSIA

MODELET E LIDHJEVE

Është një sërë modelesh të lidhjeve romantike të identifikuara nga ky vlerësim në terren, pasi që më shumë se gjysma e respondentëve (52%) kanë pasur një lidhje, një e treta e të cilëve (32%) kanë pasur ose janë në një lidhje që ka përfshirë edhe marrëdhënie seksuale. Shumica e respondentëve ishin në një lidhje në kohëzgjatje prej dy muajsh deri dy vjet, ndërsa pak më shumë se një dyzinë (14%) kanë pasur marrëdhënie për një periudhë më të gjatë se dy vjet; nga kjo e fundit konkludojmë se po kjo përqindje e respondentëve ka filluar lidhjen në një moshë mjaftë të re. Gjithashtu, gati gjysma e atyre që kanë pasur një lidhje (53%) nuk janë më në marrëdhënie romantike.

	GJITHSEJTË	MESHKUJ	FEMRA
Jo	33.3%	28.9%	40.8%
Nuk e di	8.3%	7.2%	10.2%
Kondom (prezervativ)	40.9%	51.8%	22.4%
Kam ndërprerë marrëdhënien	10.6%	10.8%	10.2%
Hapa kontraceptiv	3.8%	1.2%	22.4%
Metoda natyrore (llogaritja e ditëve të cikleve menstruale...)	3.0%	0%	8.2%

TABELA 6.0. Mbrojtja seksuale për personat seksualisht aktiv në lidhjen e tyre romantike⁸

⁸ Pjesëmarrësit kishin mundësinë që të rrethojnë më shumë se një opsion. Kjo tabelë përmban opsionin e parë.



Vërehet një tendencë ndër respondentët më të rinj që të mos shpejtojnë me kryerjen e marrëdhënieve seksuale; kjo është konstatuar pasi që prej atyre që janë ende në një marrëdhënie romantike (46%), vetëm një e katërta (24%) kanë marrëdhënie seksuale. Më shumë respondentë meshkuj (29.5%) se sa femra (17.2%) kanë raportuar përvoja seksuale si pjesë e lidhjeve të tyre romantike. Normat sociale e kulturore se femrat duhet të jenë të virgjëra⁹ para se të hyjnë në martesë mund të ketë ndikim në qëndrimet dhe sjelljet e vajzave në marrëdhëniet e tyre. Po kjo mund të jetë e vërtetë edhe për meshkujt, pasi që normat sociale e kulturore nuk i stigmatizojnë ata në rast se kanë marrëdhënie seksuale paramartesore dhe kjo mund të ndikojë që ata të jenë më liberal në praktikat dhe sjelljen e vet seksuale dhe në raportimin për to.

Në anën tjetër, më shumë se një e treta (40%) e atyre që kanë pasur marrëdhënie seksuale kanë përdorur kondom si masë mbrojtëse gjatë marrëdhënies së fundit seksuale, ndërsa një përqindje mjaft brengosëse prej 33.3% nuk kanë përdorur kurrfarë mbrojtje. Sipas këtij studimi, brengosë fakti se një numër i madh i adoleshentëve po praktikojnë seks pa mbrojtje, duke i bërë ata më të ndjeshëm ndaj sëmundjeve të ndryshme që barten përmes lidhjeve seksuale ose ndaj shtatzënive të padëshiruara. Kjo vlen sidomos për meshkujt e rinj, pasi që sipas këtij studimi 28.9% prej tyre kishin deklaruar të mos kishin përdorur kurrfarë mbrojtje gjatë marrëdhënies së fundit seksuale në lidhjen e vet romantike, ndërsa te femrat kjo vlerë ishte edhe më e lartë - 40.8%. Një element i rëndësishëm në këtë aspekt të hulumtimit (nga pikëvështrimi i përkatësisë etnike të pjesëmarrësve) ishte konstatimi se 50% e pjesëmarrësve të përgjithshëm nga pakicat etnike nuk kishin raportuar përdorimin e çfarëdo mbrojtjeje gjatë marrëdhënies së tyre të fundit seksuale në lidhjen e tyre romantike.

Dy të tretat e atyre që janë aktualisht në një marrëdhënie është se ata janë plotësisht (31%) ose kryesisht (33%) të kënaqur me marrëdhënien e tyre. Prej atyre që janë në një marrëdhënie 22% flasin shpesh, ndërsa 15% flasin çdo ditë për ndjenjat e tyre dhe, nuk ka ndonjë dallim në mes të përgjigjeve të respondentëve femra ose meshkuj. Pothuajse gjysma e tyre rrallë (31%) ose asnjëherë (17%) nuk kanë keqkuptime, gjë që mund të vërtetohet edhe nga përgjigjet e dhëna për nivelin e kënaqësisë me marrëdhënien e tyre. Një vëzhgim tjetër i rëndësishëm është se një e treta e respondentëve nuk provojnë të zgjidhin keqkuptimet ose problemet nëpërmjet të negociatave, gjë që mund të jetë burim i shqetësimit për natyrën e komunikimit në lidhje.

5.2. QËNDRIMI NDAJ ROLEVE GJINORE

Qëndrimet mësohen dhe, më vonë, ato përbrendësohen nën trysinë e veprimeve dhe fjalëve të njerëzve përreth në mjedisin politik, social dhe personal. Është e pashmangshme që adoleshentët të mos ndikohen në mënyrë direkte ose indirekte nga normat dhe të pritmet e shoqërisë; përkundër tendencave për individualitet dhe identitet të kësaj faze të zhvillimit njerëzor.

Adoleshentët gjithashtu i kemi pyetur nëse pajtohen me fjali të caktuara që përshkruajnë stereotipe gjinore përkitazi me rolet dhe identitetet e femrave e meshkujve, si dhe disa norma shoqërore lidhur me seksin dhe gjininë. Në Tabelën 1 tregohen përqindjet e personave të anketuar që janë pajtuar me deklaratat e mësipërme dhe rëndësia statistike e dallimeve të shprehura në baza gjinore.

Rezultatet tregojnë një përqindje shqetësuese të të rinjve që e bazojnë sistemin e vet të vlerave në norma dhe stereotipe gjinore.

Më saktësisht, rezultatet në tabelën në vijim ngrisin shqetësime të shumta jo vetëm për dhunën, por mbi të gjitha për qëndrimet dhe perceptimin e këtyre të rinjve ndaj dukurisë së dhunës. Këto qëndrime japin alarmin se shumë (40%) femra do të pranonin që i dashuri i tyre t'í godas nëse ajo do ta mashtronte.

Një arsye tjetër për t'u shqetësuar buron edhe nga numri i madh i adoleshentëve nga të dyja grupet gjinore që besojnë se është e pranueshme nëse partneri mashkull e godet partneren e cila e mashtron atë në lidhje. Një numër i madh i meshkujve (46%) dhe i femrave (40%) e kanë deklaruar të pranueshme këtë lloj të dhunës. Hulumtime të tjera në vend (shih Exploring Dimensions of Masculinities, Femininities and Violence with Young Men and Young Women in Kosovo; Participatory Learning Action – PLA¹⁰) kanë theksuar se adoleshentët në Kosovë e pranojnë këtë dukuri në marrëdhëniet e veta. Të rinjtë (meshkujt) besojnë se ky është një veprim i kuptueshëm, ndërsa të rejat e kanë përbrendësuar besimin se kjo duhet të jetë një gjë e pranueshme në një lidhje romantike në rast se ndodh mashtrimi. Nuk vërehet shumë dallim sa i përket këtij pikëvështrimi në mes të pjesëmarrësve të ndryshëm nga grupe të ndryshme etnike, përderisa gjithsejtë 41.6% e pjesëmarrësve nga pakicat kombëtare janë pajtuar me deklaratën e mësipërme.

Shumë prej tyre (40%) besojnë së vetëm femrat janë përgjegjëse për përkujdesjen për fëmijët dhe për punët e shtëpisë. Për më tepër, tabela në

10 Hulumtimi i Dimensioneve të Maskulinitetit, Feminitetit dhe Dhunës në mesin e të rinjve e të rejave në Kosovë; Plani i të nxëniet me pjesëmarrje – PNP

vijim, edhe një herë, e thekson një qëndrim të rëndësishëm që mbizotëron në mesin e adoleshentëve të këtij studimi nga të dyja grupet gjinore përkthazi me virgjërinë e femrës derisa ajo hyn dhe zhvillon një lidhje potenciale romantike. Më saktësisht, shumica e pjesëmarrësve, 65% syresh, besojnë se vajza duhet të jetë e virgjër në kohën kur ajo vendos të hyjë në një lidhje. Për më tepër, duket se normat shoqërore e kulturore për virgjërinë e femrës ka pasur më shumë ndikim te femrat se sa te meshkujt pjesëmarrës në këtë studim; kjo shihet në faktin se më shumë femra, 70% prej tyre, se sa meshkuj (59%) besojnë në vërtetësinë e mendimit se një vajzë duhet të jetë e virgjër kur hyn në një lidhje romantike.

Një gjetje tjetër në këtë fushë është edhe perceptimi i një të pestës së respondentëve (23%), të cilët besojnë se vajzat duhet të kenë marrëdhënie seksuale me partnerin e vet mashkull nëse ai ka shpenzuar shumë të holla gjatë kohës kur janë argëtuar dhe takuar.

Më shumë se gjysma e meshkujve të intervistuar (55%) dhe madje edhe çdo e treta vajzë (35%) nuk besojnë nëse vajza e ka me gjithë mend kur thotë 'jo'.

	PO	JO	MESH- KUJ PO	FEMRA PO
Vajza duhet të ketë marrëdhënie seksuale me partnerin nëse ai ka shpenzuar shumë para gjatë kohës kur janë argëtuar	24%	76%	33%	15%
Kur femrat thonë JO, ato në të vërtetë mendojnë PO	45%	55%	55%	35%
Burri i vërtetë është aktiv, agresiv, i pavarur dhe dominues	40%	60%	47%	34%
Nga vajza pritet të jetë e virgjër kur hyn në një lidhje romantike	65%	35%	59%	70%
Xhelozia është mënyrë për të treguar dashurinë	49%	51%	51%	47%
Personi që abuzon me njerëz të tjerë nën ndikimin e alkoolit ose drogave, nuk është përgjegjës për sjelljen e vet	44%	56%	43%	44%
Është e pranueshme që partneri mashkull ta godas femrën nëse ajo e ka mashtruar atë	44%	56%	46%	40%

Fëmijët kanë nevojë për babain edhe kur ushtron dhunë kundër nënës së tyre	44%	56%	51%	38%
Pasojat e abuzimit psikologjik / emocional janë po aq serioze sa edhe pasojat e maltremitit fizik	71%	29%	65%	75%
Dhunimi mund të ndodhë në martesë	54%	46%	56%	53%
Mund të ketë lidhje të suksesshme romantike edhe në rastet kur vajza nuk është e virgjër	69%	31%	64%	72%
Njerëzit që janë në lidhje romantike kanë prirje që t'i injorojnë shokët e vet	34%	66%	30%	37%
Gruaja duhet të jetë e kujdesshme që të mos e provokojë / sfidojë burrin	66%	34%	64%	68%
Është shumë lehtë të braktiset partneri nëse kemi vendosur të ndërpresim një lidhje të dhunshme	49%	51%	52%	46%
Njerëzit i abuzojnë dhe i maltretojnë partnerët e vet në përpjekje për t'i kontrolluar ata	60%	40%	60%	60%
Vetëm femrat janë përgjegjëse për përkujdesjen për fëmijët dhe për punët e shtëpisë	40%	60%	43%	37%
Gruaja e përkryer është pasive, e kujdesshme, e ndieshme dhe llafazane	33%	67%	33%	33%
Disa njerëzve u bënë mirë rrahja nga partneri	33%	67%	33%	33%
Njerëzit nganjëherë hidhërohen aq shumë sa që nuk i përballojnë përdorimit të dhunës fizike	56%	44%	53%	58%
Njerëzit që nuk i braktisin partnerët e vet, u pëlqen të jenë të abuzuar	29%	71%	32%	26%
Shoqëria bën presion mbi meshkujt e rinj që të hyjnë në marrëdhënie seksuale	61%	39%	58%	63%
Personat që i rrahin partnerët e vet janë gjithmonë të dhunshëm	61%	39%	53%	67%
Kur një çift përdorë dhunën për të zgjidhur problemet e ndërsjella atëherë kjo u përket vetëm atyre dhe personat e tjerë nuk duhet të ndërhyjnë	40%	60%	42%	39%
Ndonjëherë është mirë të përdoret dhuna fizike për të bindur një person për një gjë	34%	66%	39%	30%

Turpi dhe frika janë arsye të shpeshta që viktimat e dhunës nuk kërkojnë ndihmë	72%	28%	65%	79%
Është e mundur të jemi paqësor në situata të dhunshme	60%	40%	56%	67%
Ne mund të ndihmojmë miqtë tanë të cilët gjenden në lidhje të dhunshme	75%	25%	71%	79%
Djemtë dhe vajzat kanë arsye të ndryshme për të hyrë në një marrëdhënie (djemtë duan seks, vajzat duan dashuri)	69%	31%	64%	74%

TABELA 7.0. Qëndrimet ndaj roleve gjinore

PËRKUFIZIMI I DHUNËS, SIPAS ADOLESHENTËVE

6.1. (MUNGESA E TË)KUPTUARIT TË AKTEVE TË DHUNSHME

Gjetjet e këtij vlerësimi tregojnë se në përgjithësi nuk ka shumë dhunë në mes të të rinjve; mirëpo, një gjendje e tillë është vetëm pjesërisht e vërtetë sepse dhuna nuk raportohet dhe, ajo që është me rëndësi, këta të rinj nuk e kuptojnë çka është dhuna. Siç shihet nga tabela në vijim, një e treta (27%) e respondentëve besojnë se goditja me pëllëmbë nuk do të definohej si dhunë, ashtu siç nuk konsiderohet dhunë as grushtimi (16%) as tërheqja e flokëve (18%).

Rrjedhimisht, të rinjtë, sidomos meshkujt, nuk e kuptojnë se cilat veprime konsiderohen si dhunë. Nga rezultatet e kësaj tablele, mund të konkludohet se femrat mund të kuptojnë më mirë se çka mund të përkufizohet si dhunë. Më saktësisht, femrat më shumë se meshkujt janë në gjendje të identifikojnë incidentet si shkatërrimi i gjërave / pronës (77% prej tyre), goditjen me pëllëmbë (77%), bërtitjen (66%), shantazhin (57%), kërcënimin (81%), e shtyrjen (81%), si forma të dhunës. Në anën tjetër, shikuar nga perspektiva e informatave për përkatësinë demografike të pjesëmarrësve, gjithsejtë 70.4% janë pajtuar se “një shuplakë” është një lloj dhune. Njësoj vlenë edhe për bërtitjen (58%), shantazhin (60.5%), dhe shtyrjen (70%).

Kufizimi i kohës që partneri e kalon me miqtë / familjen e vet	39%	61%	40%	38%
Shkatërrimi i gjërave dhe i pronës	74%	26%	71%	77%
Pritja që partneri të jetë gjithnjë në dispozicion	43%	57%	40%	45%
Goditja me shuplakë	73%	27%	68%	77%
Ankesa për dukjen dhe sjelljen e tjetrit	36%	64%	35%	37%
Bërtitja ndaj partnerit	62%	38%	57%	66%
Insistimi në marrëdhënie seksuale	69%	31%	63%	74%
Ofendimi dhe ngjitja e emrave nënçmues (i / e marrë etj)	64%	36%	59%	68%
Tërheqja e flokëve	82%	18%	77%	86%
Goditja	84%	16%	80%	88%
Detyrimi i partnerit të bëjë marrëdhënie seksuale	80%	20%	74%	85%
Shantazhimi duke thënë: "Nëse do të më dashuroje, ti do të..."	53%	47%	49%	57%
Injorimi (sjellja gjoja se tjetri nuk ekziston)	47%	53%	39%	55%
Kërcënimi me përdorim të forcës	77%	23%	73%	81%
Partneri mashkull insiston se partnerja duhet të abortojë fëmijën kundër dëshirës së vet.	77%	23%	71%	83%
Sjellja me partnerin sikurse të ishte një gjësend	65%	35%	60%	70%
Moslejimi i shprehjes së mendimit	60%	40%	54%	65%
Xhelozia	37%	63%	33%	42%
Thashethemet	43%	57%	36%	49%
Nënçmimi	58%	42%	52%	63%
Detyrimi që të përcaktohem për shokun ose për të dashurin	63%	37%	61%	66%
Hudhja e gjërave në të dashurin	80%	20%	76%	82%
Shtyrja	76%	24%	71%	81%
Përcjellja, monitorimi, kontrollimi	60%	40%	52%	67%
Marrja e vendimeve në vend të partnerit	61%	39%	57%	64%

TABELA 8.0. Llojet / përvojat e dhunës

MODELET E DHUNËS NË LIDHJET MES ADOLESH-ENTËVE

“Meshkujt janë ata që ushtrojnë më shumë dhunë; në shumicën e rasteve, femrat janë viktimat”

Një adoleshent pjesëmarrës në grupin e fokusit

7.1. DHUNA FIZIKE

Për qëllimet e këtij studimi, “dhuna fizike ndodhë kur dikush përdor një pjesë të trupit të vet ose ndonjë objekt për të kontrolluar veprimet tuaja. Veprimet si shtyrja, mënjanimi, mbajtja përfundi, tërheqja e flokëve, goditja me shuplakë, dredhja e krahut dhe ngulfatja janë vetëm disa forma e veprime që konsiderohen dhunë fizike”.¹¹

Një në dhjetë (9%) respondentë godet me shuplakë ose e tallë (9%) partnerin dhe nuk ka dallim në mes të meshkujve e femrave që angazhohen në veprime të tilla. Një numër fare i vogël i respondentëve (4%) e tërheq për flokësh ose e shtynë partnerin e vet.

Më pak se një e treta e respondentëve (27%) nuk mendojnë se flakaresha do të përbente një akt të dhunës. Ky perceptim, që përkrahet më shumë nga meshkujt se nga femrat, tregon se nuk kuptohet sa duhet koncepti i dhunës fizike dhe ajo se çka do të përbente dhunën fizike. Ky numër i lartë është mjaftë brengosës, mirëpo mund të jetë që respondentët ta kenë kuptuar “dhënien e një flakareshe” më shumë si një veprim të padhunshëm të prekjes se sa si një goditje serioze me pëllëmbë të dorës. Ka një tendencë gjithashtu që bërtitja të mos shihet si një akt i dhunës, një pikëvështrim i shprehur nga një numër i konsiderueshëm (37%) i respondentëve.

Respondentët do të ndërmerrnin një sërë veprimesh, por disa prej tyre (39%) do të ndërprisnin lidhjen nëse do të goditeshin nga partneri, ndërsa më pak prej tyre (8%) dë të kishin kthyer goditjen me goditje. Më shumë vajza (11%) se sa meshkuj (6%) kanë përjetuar goditje / lëndim fizik ose kanë pësuar flakareshë, gjë që përbën një gjetje tjetër interesante nga ky vlerësim.

Më pak se gjysma e respondentëve (43%) pajtohen se është e pranueshme që djali ta godas vajzën nëse ajo e ka mashtruar atë – një veprim që

¹¹ Nisjativa për Parandalimin e Dhunës e Qeverisë së Njufundlëndit dhe Labradorit, Kanadë. E nxjerrë nga [www](http://www.gov.nl.ca/VPI/index.html) më 12 nëntor 2012 në <http://www.gov.nl.ca/VPI/index.html>

kundrohët njësoj si nga gjysma e respondentëve meshkuj (46%) dhe femra (40%). Një e treta (33%) e respondentëve mendojnë se disa njerëzve u bënë mirë nëse marrin goditje nga partneri i tyre. Edhe nga këto gjetje konstatohet se në mesin e respondentëve nuk kuptohen si e sa duhet koncepti dhe elementet e dhunës.

Disa (7%) respondentë kishin përjetuar që partneri i tyre ishte sjellë në mënyrë të dhunshme kundër personave të tjerë; kjo ka shkaktuar frikë edhe ndër respondentët. Disa të tjerë (8%) kanë përjetuar që partneri i tyre t'i godiste me grusht ose me flakareshë, ndërsa 21 % ishin dëshmitarë të sjelljeve të skajshme me dy personalitete të partnerit të vet duke lëvizur prej personit shumë të këndshëm deri në person shumë agresiv. Femrat janë dy herë më të frikësuara se sa meshkujt në rastet kur partneri vepron dhunshëm kundër të tjerëve.

Një e katërta e respondentëve (25%) nuk mendojnë se shkatërrimi i gjërave ose i pronës personale do të përkufizohej si sjellje e dhunshme. Shumica e respondentëve (60%) nuk pajtohen se burri i vërtetë është aktiv, agresiv, i pavarur dhe dominues.

7.2. DHUNA SEKSUALE

“Dhuna seksuale ndodh kur dikush ju detyron të merrni pjesë në një aktivitet seksual përkundër dëshirës tuaj. Dhuna seksuale përfshinë, por nuk kufizohet në aspektet në vijim: prekja në mënyrë seksuale kundër dëshirës tuaj (p.sh. puthja, shtrëngimi, përkledhja); marrëdhënia e detyruar seksuale; përdorimi i një arme për t'ju detyruar që të pajtoheni me një akt seksual; nënçmimi, kritikata e vazhdueshme, orvatjet për të kontrolluar seksualitetin e një femre; refuzimin e informacioneve dhe arsimimit seksual (p.sh. kontrollin e lindjeve); moslejimi i afrimit seksual; aborti i detyruar ose sterilizimi; detyrimi në prostitucion”¹²

Nga përgjigjet e respondentëve për këtë vlerësim mund të konkludojmë se vetëm një numër i vogël i respondentëve (3%) i detyrojnë partnerët e vet që të kenë marrëdhënie seksuale. Ky rezultat vërtetohet edhe nga gjetjet e tjera, megjithëse këto tregojnë se femrat (4%) më shumë se meshkujt (2%) i detyrojnë partnerët e vet të hyjnë në marrëdhënie seksuale edhe në rastet kur ata nuk janë gati. Disa (8%) thonë se ai/ajo do të ndahej nga ai / ajo nëse nuk do të kishte marrëdhënie seksuale.

12 Nisjativa për Parandalimin e Dhunës e Qeverisë së Njufundlëndit dhe Labradorit, Kanadë. E nxjerrë nga www.gov.nl.ca/VPI/index.html më 12 nëntor 2012 në

Një gjetje tjetër interesante ishte se një dyzinë e respondentëve (12%) nuk ngurrojnë të përdorin shantazhin për të fituar atë që dëshirojnë, ndërsa vetëm disa (7%) e përdorin shantazhin për të detyruar partnerin në marrëdhënie seksuale. Vlerësimi tregon se ekziston një e treta shumë shqetësuese e respondentëve (31%) që mendojnë se insistimi në marrëdhënie seksuale nuk është akt i dhunës. Një në dhjetë respondentë (10%) e kanë bindur partnerin e vet që të hiqte dorë nga përdorimi i mbrojtjes gjatë marrëdhënies seskuale, edhe në rastet kur pala tjetër ka dashur t'i përdorte ato. Ka edhe një përqindje e konsiderueshme (11%) e respondentëve të cilët ndihen të shfrytëzuar pas aktit seksual. Një gjetje interesante në këtë kuptim qëndron në perceptimin negativ të një të pestës së respondentëve (23%) që besojnë se vajzat duhet të kenë marrëdhënie seksuale me partnerin nëse ai ka shpenzuar shumë të holla gjatë kohës kur janë argëtuar së bashku.

Studimi tregon se nxënësit e rinj, veçanërisht nxënëset, janë të prirura që të besojnë se virgjëria është deri diku (16%) ose shumë (61%) e rëndësishme në një lidhje. Shumica e respondentëve vërtetë mendojnë se nga vajza pritet që të jetë e virgjër para se të hyjë në një lidhje, gjë që pasqyron ndikimet religjioze e kulturore. Gjysma e respondentëve besojnë se seksi është deri diku (28%) ose shumë (22%) i rëndësishëm në një marrëdhënie, ndërkaq një e pesta (19%) besojnë se seksi nuk është i rëndësishëm.

Pothuajse të gjithë respondnetët kanë parë ose përjetuar, ndërkaq pak prej tyre (5%) edhe kanë bërë komente ose shaka për seksualitetin e dikujt në shkollë. Shumë (70%) pajtohen se vajzat dhe djemtë kanë arsye të ndryshme për të hyrë në një marrëdhënie (djemtë duan seks, vajzat duan dashuri).

7.3. DHUNA EMOCIONALE

“Dhuna emocionale ndodhë kur dikush thotë ose bën diçka që ju bën të ndiheni i marrë ose i pavlerë. Dhuna emocionale përfshinë, por nuk kufizohet me, gjërat në vijim: ngjitja e emrave nënçmues; kritikata e vazhdueshme; fajësimi i partnerit për të gjitha problemet e lidhjes; nënçmimi ose zvogëlimi i figurës tuaj para të tjerëve; moslejimi që të keni kontakt me familjen e me miqtë; kërcënimet; xhelozia;”¹³

Një dyzinë (13%), përfshirë numër të njëjtë të respondentëve meshkuj e femra thonë gjëra që e nënçmojnë / ofendojnë partnerin para të tjerëve. Presioni nga marrëdhënia është e qartë në disa raste pasi që gati një e treta (28%) e respondentëve më parë pajtohen me një gjë se sa ta kundërshtojnë

¹³ Nisjativa për Parandalimin e Dhunës e Qeverisë së Njufundlëndit dhe Labradorit, Kanadë. E nxjerrë nga www më 12 nëntor 2012 në <http://www.gov.nl.ca/VPI/index.html>

pasi që e kanë të vështirë ose nuk guxojnë të thonë “jo”. Rezultatet tregojnë se vajzat janë më të prirura që të ndjehen keq ose të frikësohen në raste të tilla.

Xhelozia është një veprim tjetër që shpesh vërehet në këto lidhje. Shumica e respondentëve (65%) janë dëshmitarë të shfaqjes së xhelozisë nga ana e partnerëve të vet; meshkujt (67%) dhe femrat (63%) nuk dallojnë shumë për veprime të këtilla. Një e katërta (23%) e respondentëve kanë shkëmbyer akuza me partnerin për flirtim me të tjerë ose për tradhti. Rezultatet tregojnë se meshkujt akuzohen më shpesh nga partneret e tyre se sa e kundërta.

Një perceptim tjetër negativ i pranishëm në mesin e këtyre të rinjve ka të bëjë me kontrollimin e partnerit në lidhje. Shumë respondentë (60%) nuk mendojnë se kufizimi i kohës të cilën partnerët e kalojnë me miqtë ose me familjen do të përbënte sjellje të dhunshme. Më shumë se gjysma e respondentëve nuk e konsiderojnë injorimin (52%) ose xhelozinë (62%) si sjellje të dhunshme; ky perceptim u shkon më shpesh meshkujve e më rrallë femrave.

Këta nxënës në përgjithësi e kuptojnë rëndësinë e komunikimit në një lidhje romantike. Shumica e respondentëve besojnë se komunikimi është deri diku (11%) ose shumë (78%) i rëndësishëm; femrat janë të prirura ta besojnë këtë më shumë se meshkujt. Shumica e respondentëve mendojnë se kompromisi është deri diku (15%) ose shumë (60%) i rëndësishëm në një lidhje; e ngjashme është situata edhe lidhur me të folurit për ndjenjat.

Një e katërta e respondentëve (25%) nuk janë të sigurtë ose nuk besojnë se lëshimi pe është i rëndësishëm në një lidhje. Një në katër veta (23%) e fajëson tjetrin për sjelljen e keqe të dikujt tjetër kundrejt tij/saj, duke thënë se vet e ka kërkuar. Një e treta (32%) e respondentëve e kanë detyruar njëri-tjetrin të bëjë diçka duke i bërë që të ndihen fajtorë me fjalët “Po të më doje me të vërtetë ti do të...”

7.4. DHUNA PSIKOLOGJIKE

“Dhuna psikologjike ndodhë kur dikush përdorë kërcënime dhe shkakton frikë te ju për të fituar kontroll. Dhuna psikologjike përfshinë, por nuk kufizohet me, gjërat në vijim: kërcënimi për të ju dëmtuar ju, fëmijët ose familjen tuaj nëse largoheni; kërcënimi se do ta lëndojnë vetveten; kërcënimi me braktisje; izolimi social nga familja dhe miqtë tuaj; kufizimi i lëvizjeve brenda shtëpisë; nënçmimi i vazhdueshëm.”¹⁴

¹⁴ Nisjativa për Parandalimin e Dhunës e Qeverisë së Njufundlëndit dhe Labradorit, Kanadë. E nxjerrë nga www.gov.nl.ca/VPI/index.html më 12 nëntor 2012 në

Nga gjetjet e hulumtimit mund të konkludohet në përgjithësi se ekziston dhuna psikologjike dhe se të rinjtë nuk janë të vetëdijshëm për atë se çka përbën dhunën e tillë. Një e treta e respondentëve (32%) veprojnë me xhelozzi ekstreme, ndërsa janë më të pakët (19%) ata që sillen sikur partneri i tyre të ishte pronë e tyre. Është një numër shqetësues (40%) i atyre që nuk e konsiderojnë nënçmimin si dhunë, siç nuk mendojnë as për përcjelljen, monitorimin ose kontrollimin. Disa (15%) e shohin veten si më të pavlefshëm për shkak të partnerit të vet.

Të dhënat e fituara tregojnë se femrat (34%) më shumë se meshkujt (27%) i kontrollojnë lëvizjet e partnerit edhe përkundër faktit se pikërisht ato (më shumë se meshkujt) e konsiderojnë një gjë të tillë një veprim të dhunshëm. Më pak se një e pesta (18%) e respondentëve ndihen të izoluar ose të veçuar nga miqtë; femrat e kanë këtë ndjenjë dy herë me shpesh se meshkujt.

Frika nga braktisja është po ashtu mjaftë e pranishme dhe e dukshme në lidhjet e këtyre të rinjve. Një në dhjetë (10%) pajtohen të kenë marrëdhënie seksuale vetëm që të mos braktisen nga partneri. Ka një pjesë shqetësuese e respondentëve (22%) të cilët nuk do të konsideronin dhunë nëse partneri do të insitonte që vajza të abortonte përkundër dëshirës së saj.

7.5. DHUNA E SHKAKTUAR NË LIDHJET ROMANTIKE

Tabela në vijim sjell në pah disa rezultate interesante. Nga respondentët ishte kërkuar të tregojnë nëse fjalitë në kutija kishin ndodhur dhe nëse ata i kishin bërë partnerët e vet që të veprojnë në mënyrë të tillë. Është interesant se në një numër të madh të këtyre rasteve, femrat kanë prirje që të jenë më të dhunshme se meshkujt. Për shembull, më shumë meshkuj se femra thonë se partneri i tyre sillet në mënyrë posesive. Femrat hedhin më shumë gjëra në partnerin e tyre dhe thejnë më shumë gjëra se partneri i tyre. Femrat gjithashtu akuzojnë më shumë se meshkujt për tradhti në lidhjen e tyre.

Më saktë, është një numër i madh i pjesëmarrësve, nga të dyja grupet gjinore, ku meshkujt janë në masën 68% ndërsa femrat 63%, që kanë raportuar një përvojë të përbashkët të xhelozisë në lidhjen e tyre. Në anën tjetër, më shumë femra (10%), se sa meshkuj (6%), kanë raportuar përvoja nga lidhja e tyre romantike ku partneri është sjellë në mënyrë agresive kundër personave të tretë dhe kështu kanë ndjellë frikë tek ata. Sipas pjesëmarrësve **34** në këtë studim, meshkujt duket të jenë më të prirur për sjellje të dhunshme madje edhe ndaj të tjerëve që në një mënyrë më direkte ose indirekte janë



të përfshirë në lidhjen e tyre romantike. Aktet e xhelozisë e të dhunës mund të ndërliohen me normat kulturore e sociale që u atribuohen meshkujve si mbrojtja / sigurimi i jetesës dhe përjashtimi i të tjerëve.

Në anën tjetër, është me rëndësi të theksohet se adoleshentët e të dyja grupeve gjinore të kenë raportuar ndonjë përvojë të asaj që në psikologji quhet atribuum i viktimës, ku një person fajësohet edhe në rastet kur dikush tjetër sillet në mënyrë negative (sjellje e keqe, veprim i pahijshëm e të tjera) ndaj tij/saj.

	PO	JO	MESH-KUJ PO	FEMRA PO
Vepron me xheloz	66%	34%	68%	63%
Sillet në mënyrë posesive, sikur dikush të ishte pronë e tij/saj	26%	74%	28%	22%
Thotë se je i/e marrë dhe të ngjet emra	12%	88%	11%	11%
Ta bën të qartë se asgjë që bën ti nuk vlenë	25%	75%	28%	21%
Thotë se do të të braktisë nëse nuk do të kesh marrëdhënie seksuale me të	8%	92%	10%	7%
Të fajëson nëse dikush sillet keq ndaj teje duke thënë se vet e kerkove	24%	76%	27%	19%
Të detyron në marrëdhënie seksuale edhe nëse nuk je gati	4%	96%	5%	2%
Sillet dhunshëm ndaj të tjerëve, duke ju shkak-tuar kështu frikë juve	8%	92%	6%	10%
Ju gjuan me gjëra ose i then gjërat tuaja me qëllim	5%	95%	7%	2%
Ju sjellë në situata të pavolitshme dhe ju tallë para njerëzve të tjerë	8%	92%	11%	4%
Ju akuzon për flirtim me persona të tjerë ose për tradhëti	24%	76%	30%	15%
Kërcënon se do të ju lëndojë ju ose një person të rëndësishëm për ju	7%	93%	9%	4%
Orvatet të ju detyrojë të bëni diçka duke zgjuar tek ju ndjenjën e fajit me fjalët: "Po të më doje me të vërtetë, ti do të..."	32%	68%	29%	25%

Refuzon të përdorë mjete mbrojtëse gjatë marrëdhënies seksuale, madje edhe nëse ju dëshironi t'i përdorni ato	10%	90%	11%	9%
Merr vendime për ju	16%	84%	16%	17%
Ju ka lënduar / goditur fizikisht ose ju ka goditur me shuplakë	9%	91%	7%	11%
Kërkon nga ju shpjegim për çkado që bëni, kudo që shkoni dhe për çdo person që takoni	29%	71%	30%	27%
Përhapë thashetheme për ju	14%	86%	19%	8%
Ju shtynë ose ju kapë për flokësh	3%	97%	4%	2%
Ju detyron të bëni marrëdhënie seksuale	5%	95%	5%	4%
Sillet sikur t'i kishte dy personalitete (duke lëvizur prej shumë i këndshëm e deri te shumë agresiv)	22%	78%	23%	20%

TABELA 9.0. Dhuna në lidhjet romantike

(MOS)RAPORTIMI I DHUNËS

Sipas të rinjve të anketuar në kuadër të këtij studimi, raportimi i pranisë së dhunës në një lidhje romantike nuk shihet me sy të mirë nga shoqëria pasi që nxitë ndjenjën e turpfit. Shumica e pjesëmarrësve e kanë emëruar turpin si arsyen dhe pengesën kryesore që i shtynë njerëzit që të mos e raportojnë dhunën në lidhjen e tyre. Një ndjenjë e këtille është më e pranishme ndër femrat (29.1%) se sa te meshkujt (24.6%). Kjo mbase do të mund të lidhej me të pritmet që janë ende të pranishme se gjërat private dhe ato familjare mbesin private dhe se nëse ndodhë diçka e keqe për të cilën dinë të gjithë, atëherë njeriu duhet të ndihet fajtor dhe i turpëruar për këtë. Kjo është sikur e gjithë kjo të ishte për fajin e tij/saj.

Është me rëndësi të vërejmë se pjesëmarrëset në studim kanë treguar për frikën nga hakmarrja (16.1% për femra dhe 10.3% për meshkujt) si një arsye tjetër e rëndësishme për mosraportimin e dhunës, ndërkaq më shumë meshkuj (19.6%) se femra (10.1%) kanë raportuar një ndjenjë të fajit dhe të përgjegjësisë për dhunën si një nga arsyet kryesore për mosraportimin e **36** dhunës.

	GJITHSEJTË	MESHKUJ	FEMRA
Ndjenja e fajit dhe përgjegjësia për dhunën	14.6%	19.6%	10.1%
Pamundësia për të dalluar sjelljen e dhunshme	4.9%	5.0%	4.7%
Ndjenja e turpfit	27%	24.6%	29.1%
Frika nga leçitja dhe braktisja	12.9%	13.9%	12.0%
Mohimi i dhunës së përjetuar	3.5%	3.6%	3.5%
Frika nga hakmarrja	13.4%	10.3%	16.1%
"Nuk e vlenë të raportohet, askush nuk mërzitët për këtë punë"	12.1%	10.3%	13.6%
Frika se askush nuk do të ju besojë	7.2%	7.1%	7.3%
Frika nga marrja në pyetje nga policia ose gjykatat ...	4.5%	5.7%	3.5%

TABELA 10 Arsyet / pengesat për mosraportimin e dhunës

Për më tepër, është po aq me rëndësi që shumica e pjesëmarrësve të këtij studimi mendojnë se dhuna është e pranishme sot në lidhjet romantike dhe se ajo paraqet problem dhe shqetësim serioz. Gjithsejtë, femrat (me 84.2%) dukshëm më shumë se meshkujt (me 68.3%) e kanë ngritur këtë si një çështje alarmuese për marrëdhëniet bashkëkohore. Sa i përket përkatësisë etnike të pjesëmarrësve të këtij studimi, gjithsejtë 81.5% e pakicave po ashtu janë pajtuar me pohimet e mësipërme.

Një çështje tjetër po aq alarmuese, paraqet numri i pjesëmarrësve meshkuj (19.2% prej tyre krahasuar me 9.8% të femrave), të cilët besojnë se edhe përkundër ekzistimit të rasteve të sjelljes së dhunshme në lidhjet romantike, ato nuk do të duhej të bëheshin publike dhe nuk do të duhej të problematizoheshin si çështje që meritojnë vëmendje. Ata që përjetojnë dhunë në lidhjen e tyre janë lënë pothuajse pa kurrfarë ndihme dhe pa asnjë strategji parandaluese pasi që sipas shumicës (86.6%) së pjesëmarrësve në anketë, nuk ka asnjë aktivitet, punëtori, udhëzime apo fushata për parandalimin e qëndrueshëm dhe efektiv të dhunës.

	GJITHSEJTË	MESHKUJT	FEMRA
JO	9.0%	12.5%	6.0%
Ndoshta në disa raste, mirëpo unë mendoj se do të duhej problematizuar kjo çështje	14.2%	19.2%	9.8%
PO, ekziston dhe është problem serioz	76.7%	68.3%	84.2%

TABELA 11: Prania e dhunës në lidhjet romantike

MODELET E MEDIAVE

“Besoj se në njëfarë mënyre, ne të gjithë orvatemi t’i kontrollojmë gjërat nëpërmjet të mediave të rrjeteve sociale” – Pjesëmarrës adoleshent në grupin e fokusit

Shumica e respondentëve nuk janë të sigurtë (21%) ose mendojnë (51%) se mediat nuk u përshtaten personave dhe situatave reale gjatë raportimit për marrëdhënie në mes të femrave e meshkujve. Ndjenja e turpit (27%) dhe e fajit (14%) janë arsyt kryesore për respondentët që njerëzit nuk i raportojnë përjetimet e dhunshme në lidhjet e veta. Kjo vlen më shumë për femrat se sa për meshkujt. Pothuajse të gjithë respondentët nuk janë të sigurtë (20%) ose mendojnë se mediat (68%) nuk ndikojnë në sjelljen e tyre seksuale.

Fatkeqësisht, programet shkollore nuk ofrojnë njohuri të duhura që do të synonin përmirësimin e të kuptuarit të dhunës në një marrëdhënie. Një numër i kufizuar (13%) i respondentëve kanë përfituar nga programet shkollore (punëtori, fushata) që merren me parandalimin e dhunës në një marrëdhënie.

GJETJET E TJERA

- Shumica e respondentëve që kishin përjetuar veprime të dhunshme nuk ndiheshin mirë, ose ishin të pasigurtë e mosbesues. Ata zakonisht kanë reaguuar në vetëmbrojtje, kanë kërkuar ndihmë ose këshillë, ose kanë heshtur ndaj veprimeve të tilla. Disa (18%) madje kanë ndryshuar sjelljen e vet në shtëpi e në lidhjen e vet. Në rastet kur respondentët janë sjellë në mënyrë të dhunshme, ata e shpjegojnë këtë me vetëmbrojtje (30%) ose xheloz (32%).
- Një e pesta (23%) e respondentëve e njohin dikë që është në një lidhje të dhunshme, ndërsa rezultatet e studimit tregojnë se gati gjysma (44%) e respondentëve kanë ndonjë person të besueshëm për të cilin janë të brengosur qëkur ai person ka hyrë në një lidhje. Përderisa brengosja mund të burojë nga prania e dhunës në lidhje, nuk duhet injoruar edhe mundësia e brengosjes se personi nuk e ka gjetur personin e duhur.
- Dhuna duket të jetë gjerësisht e pranishme në jetën e respondentëve të studimit. Pothuajse të gjithë ata (98%) kanë parë ose përjetuar përhapjen e thashethemeve ose gënjeshtreve si në shkollat e tyre ashtu edhe në lagje. Gati të gjithë (98%) kanë parë ose përjetuar vjedhje ose dëme, si në shkollë dhe në lagje. Pothuajse të gjithë (97%) respondentët kanë parë ose përjetuar kërcënime me armë (thikë, revolver) në shkollë ose në lagje. Pak respondentë (3%) nuk ngurrojnë të raportojnë se ata kanë bërë një gjë të tillë edhe vet.
- Është interesant se rezultatet tregojnë se shumë persona kanë parë ose dëgjuar për dhunën, përkundër një numri të vogël të rasteve të raportuara – madje edhe nga respondentët e këtij anketimi. Më pak se (40%) e respondentëve njohin persona që ushtrojnë sjellje të dhunshme kundër partnerit të vet në rrethin e ngushtë të shoqërisë. Sjellja e dhunshme tolerohet (29%) dhe idealizohet (27%) nga disa respondentë.



REKOMANDIMET

- Bazuar në nevojat dhe shqetësimet e identifikuar të të rinjve e të rejave dhe të theksuara nga rezultatet e këtij studimi, janë sugjeruar rekomandimet në vijim:
- Të hartohen, organizohen dhe jetësohen nisma e aktivitete brenda shkollave dhe në kuadër të kurrikulës zyrtare ose / edhe si aktivitete jashtëkurrikulare, të cilat kanë për synim strategjitë parandaluese dhe krijimin e mundësive.
- Fushata të mdhaja edukative me qëllim të ngritjes së vetëdijes së të rinjve për të kuptuarit e drejtë të dhunës dhe formave të ndryshme të dhunës të pranishme në jetën e tyre, qofshin ato fizike, emocionale, psikologjike dhe seksuale. Më saktë, arritja e një shkalle të vetëdijes ku konceptet dhe rastet e “shuplakës”, “shtyrjes” e “ofendimit” konsiderohen formë e dhunës.
- Fushata vetëdijesimi për dukurinë, shkaqet dhe vendet më të shpeshta të dhunës në shkollë ose në lidhje romantike, si dhe të identifikohen e të sugjerohen teknikat e strategjitë për zvogëlimin, nëse jo eliminimin, e dhunës.
- Përfshirja e palëve të interesuara në fushën e arsimit (mësimdhënësve, udhëheqjes arsimore, prindërve dhe nxënësve) për identifikimin dhe zbatimin e teknikave për parandalimin e dhunës, në veçanti brenda mjediseve shkollore për llojet dhe format e dhunës shkollore.

BIBLIOGRAFIA

- Brajshori, Muhamet. (2011). Dhuna në shkollë bëhet vdekjepurëse. Southeast European Times në Prishtinë. Nxjerrë nga interneti më 12 nëntor 2012 nga www në http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2011/06/08/feature-04
- Exploring Dimensions of Masculinities, Femininities and Violence with Young Men and Young Women in Kosovo; Participatory Learning Action – PLA Kosovo. (2012). Young Men Initiative, CARE International.
- Kadriu, E., Selimos, E., Tower, J. (2010), What it takes to be a Good Teacher?. International Progressive Education, Kosova.
- Koha DITORE Publikuar: 08.10.2012
- UNICEF (2005). Research into Violence against Children in Schools in Kosovo.
- The Violence Prevention Initiative of the Government of Newfoundland and Labrador, Canada. Retrieved from the World Wide Web on November 12,2012 at <http://www.gov.nl.ca/VPI/index.html>



Qendra Kosovare e Studime Gjinore (QKSGJ) është një organizatë joqeveritare, e cila ka për mandat strategjik që të përfshijë perspektivën gjinore në të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare duke zhvilluar studime e politika gjinore të cilat janë të ndjeshme ndaj aspekteve gjinore.

Qëllimi i Qendrës është që të shërbejë si katalizatorë për ndryshime në hulumtimet, analizat e politikave dhe shpërndarjen e informacioneve në shoqërinë kosovare dhe që nëpërmjet të aktiviteteve të veta të informojë organizatat joqeveritare e qeveritare, studentët e mësimdhënësit e universiteteve, gazetarët, hartuesit e politikave e të tjera.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ)

Telefoni: (381) 38 735 991

Email: Info@kgscenter.net

Adresa: Nëna Terezë No. 18/1

Prishtinë, Kosovë

www.kgscenter.net